



**Klubi i Futbollit ERZENI**  
**NUIS M1129702H**  
**SHIJAK- SHQIPËRI**

Nr. 3722. Prot  
Duke 31.05.2022

Date 25 / 05 / 2022

## **KËRKESË**

**DREJTUAR** : BASHKISË SHIJAK

**BAZA LIGJORE** : LIGJ Nr.7850, datë 29.7.1994 PËR KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i ndryshuar, LIGJi Nr. 79/2017 PËR SPORTIN Ndryshuar me LIGJ Nr. 105/20201

**KËRKUES** : SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, regjistruar me nr. 730 akti nr.6546 vendimi datë 06.10.2020 dhe identifikuar me NUIS M11929702H, përfaqësuar nga Kryetari Z. Ardian JASIMI

### **Të nderuar zotërinj !**

Duke qenë se Bashkia Shijak në cilësinë e organit të pushtetit vendor që sipas ligjit është e ngarkuar me ndjekjen e politikave sportive në territorin e Bashkisë.

Duke qenë se SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, regjistruar me nr. 730 akti nr.6546 vendimi datë 06.10.2020 dhe identifikuar me NUIS M11929702H, është anëtare e FSHF dhe përgjegjëse për organizimin e garave sportive në sportin e futbollit me ekipin e parë dhe ekipet zinxhir, ju drejtohem me këtë kërkesë për kalimin në huapërdorje të stadiumit TOFIK JASHARI Shoqatës KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI.

Meqënëse SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, është anëtare e FSHF dhe zhvillon garat sportive në stadiumin TOFIK JASHARI, ka të drejtën që ti kërkojë Federatës në të cilën bën pjesë investimin dhe përmirësimin e ambjenteve sportive.

Meqënëse SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, është organizatë jofitimprurëse, i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet që të ardhurat ti shfrytëzojë për përmirësimin e ambjenteve sportive.

Kërkesa jonë për kalimin në huapërdorje të stadiumit argumentohet me aftësitë dhe kapacitetet që ka SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI për thithjen e investimeve që në fund të fundit janë investime që bëhen për qytetin e Shijakut dhe brezat e rinj që do të vijnë.

Mbetet në diskrecionin dhe vullnetin e Bashkisë Shijak të vendosë nëse do të jetë kontribuese në varësi të pjesmarrjes në politikat sportive për të investuar në sektorin sportiv.

Me konsideratë,

**KRYETARI**  
**ARDIAN JASIMI**



## KERKESE

**OBJEKTI** : Për kalimin në huapërdorje të stadiumit "TOFIK JASHARI" Shoqatës KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI

**BAZA LIGJORE** : Neni 901,i Ligjit Nr 7850 date 29.07.1994 "Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, I ndryshuar, Ligji Nr. 79/2017 PËR SPORTIN, ndryshuar me ligjin Nr. 105/2020, Ligji Nr.7892, datë 21.12.1994 PËR SPONSORIZIMET, i ndryshuar

**DREJTUAR** BASHKISË SHIJAK

Të nderuar zotërinj !

Duke qenë se Bashkia Shijak në cilësinë e organit të pushtetit vendor që sipas ligjit është e ngarkuar me ndjekjen e politikave sportive në territorin e Bashkisë.

Duke qenë se Bashkia Shijak në cilësinë e pronarit të ambientit sportiv konkretisht stadiumit TOFIK JASHARI, sipas VKM për kalimin e pronave publike në favor të Bsshkisë Shijak por dhe sipas dispozitave të ligjit për sportin është përgjegjëse për pronësinë e ambienteve sportive në territorin e Bashkisë Shijak.

Duke qenë se SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, regjistruar me nr. 730 akti nr.6546 vendimi datë 06.10.2020 dhe identifikuar me NUIS M11929702H, është anëtare e FSHF dhe përgjegjëse për organizimin e garave sportive në sportin e futbollit me ekipin e parë dhe ekipet zinxhir, ju drejtohem me këtë relacion për kalimin në huapërdorje të stadiumit TOFIK JASHARI Shoqatës KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI.

Kërkesa jonë për kalimin në huapërdorje të stadiumit argumentohet me aftësitë dhe kapacitetet që ka SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI për thithjen e investimeve që në fund të fundit janë investime që bëhen për qytetin e Shijakut dhe brezat e rinj që do të vijnë.

Neni 19  
Shoqatat sportive

1. Shoqatat sportive kanë për qëllim pjesëmarrjen në veprimtari sportive ose zhvillimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Mënyra e krijimit, forma e organizimit dhe e funksionimit dhe objekti i veprimtarisë së shoqatave sportive mbështeten në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, kuadrin ligjor për organizatat jofitimprurëse dhe për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe në bazë të këtij ligji.





3. Shoqatat sportive kombëtare nuk mund të zhvillojnë veprimtari sportive ose të marrin pjesë në to pa u regjistruarsi anëtare në federatën shqiptare të sportit përkatës.

4. Shoqatat sportive mund të përfitojnë financime edhe nga organet e pushtetit qendror ose vendor, në zbatim të dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi, nëpërmjet transfertave dhe nga burime të tjera.

#### Neni 30

##### Objektet sportive

1. Objektet sportive janë publike ose private.

2. Objektet sportive publike janë në pronësi të pushtetit qendror ose atij vendor, sipas juridiksionit të tyre. Ata janë përgjegjës për mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e tyre.

3. Objektet sportive ngrihen dhe mirëmbahen për krijimin e kushteve për ushtrimin e veprimtarive sportive.

#### Neni 31

##### Ndërtimi i objekteve sportive

1. Objektet sportive për zhvillimin e veprimtarive sportive zyrtare ndërtohen në përputhje me standardet dhe kushtet teknike të miratuara nga federatat ndërkombëtare të sportit përkatës.

2. Administratorët dhe shfrytëzuesit e mjediseve sportive garantojnë rregullat teknike të sigurisë dhe ato higjieno-shëndetësore për shfrytëzimin dhe frekuentimin e rregullt e normal të mjediseve sportive.

#### Neni 32

##### Përdorimi i objekteve sportive

1. Organet shtetërore ose organizatat sportive, që kanë në pronësi ose në përdorim objekte sportive, duhet të bëjnë një herë në vit verifikimin paraprak të kushteve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Në rastet kur konstatohet se kushtet dhe kriteret nuk janë plotësuar sipas standardeve të miratuara nga organizatat ndërkombëtare të sporteve përkatëse, organet shtetërore ose organizatat sportive, që kanë në pronësi ose në përdorim objekte sportive, marrin masa për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive sportive deri në përmbushjen e tyre.

#### Neni 33

##### Shfrytëzimi i objekteve sportive

1. E drejta e shfrytëzimit të objektit sportiv i takon personit fizik apo juridik, që ka në administrim objektin sportiv apo kujtdo tjetër të cilit ky i fundit i jep të drejtën e shfrytëzimit.

2. E drejta e shfrytëzimit të veprimtarisë sportive, që zhvillohet në objektin sportiv, i përket organizatorit të kësaj veprimtarie.

3. Marrëdhëniet ndërmjet pronarit ose administratorit dhe organizatorëve të veprimtarisë ose shfrytëzuesit të objektit sportiv, për qëllim të veprimtarisë sportive, rregullohen nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore.

4. Zotëruesi i së drejtës së shfrytëzimit të një veprimtarie sportive nuk mund t'u vërë sportistëve, pjesëmarrës në këtë veprimtari sportive, asnjë detyrim



që cenon lirinë e tyre, qoftë atë të të shprehurit apo çdo lloj lirie tjetër individuale.

#### Neni 34

##### Destinacioni i objekteve sportive

Destinacioni i objekteve sportive publike nuk mund të ndryshojë, pavarësisht nga subjekti administrues.

Në bazën ligjore të sipërcituar është përcaktuar nga ligjvënësi të drejtat dhe detyrimet e shoqatave sportive por dhe të pronarit të objektit sportiv në lidhje me destinacionin dhe administrimin e objekteve sportive.

Meqënëse SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, është anëtare e FSHF dhe zhvillon garat sportive në stadiumin TOFIK JASHARI, ka të drejtën që ti kërkojë Federatës në të cilën bën pjesë investimin dhe përmirësimin e ambjenteve sportive.

Meqënëse SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI, është organizatë jofitimprurëse, i ka të gjitha mundësitë dhe kapacitetet që të ardhurat ti shfrytëzojë për përmirësimin e ambjenteve sportive.

Harmonizimi i politikave të Klubit me FSHF, do të thotë që cdo zhvillim sportiv apo prioritetet për zhvillimin e talenteve të reja do të bëhet në kohën dhe me hapat e duhur.

Ky bashkëpunim i pushtetit vendor dhe shoqatës në aspektin ekonomik do të clironte buxhetin e Bashkisë Shijak nga barra fiskale për investime në ambjentet sportive duke qenë se është SHOQATA KLUBI I FUTBOLLIT ERZENI që me buxhetin e saj dhe mbështetjen e FSHF apo SHRFD të investojë në sektorin sportiv.

Mbetet në diskrecionin dhe vullnetin e Bashkisë Shijak të vendosë nëse do të jetë kontribuese në varësi të pjesmarrjes në politikat sportive për të investuar në sektorin sportiv.

Ky bashkëpunim i pushtetit vendor dhe shoqatës si organ i pavaruar, i rregulluar sipas dispozitave ligjore në fuqi krahas thithjes së investimeve strategjike në sektorin sportiv, do të shërbejë edhe si promovues i qytetit të Shijakut nëpërmjet arritjeve në garat futbollistike kombëtare dhe ndërkombëtare.

Bashkangjitur këtij relacioni do të gjeni një projekt, ku shoqata ka synimin për të aplikuar në FSHF dhe për të përfutur investimin me qëllim përmirësimin e të gjithë infrastrukturës sportive në stadiumin TOFIK JASHARI, SHIJAK.

Me konsideratë

DREJTORI LIGJOR  
Av. KRENAR BARDHI

